



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.859/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Gllgjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Komunës së Prizrenit Brikena Karavidaj, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.859/2021 i datës 03.11.2021, nga Brikena Karavidaj, kandidate për anëtare të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK,) me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërim i votave në vendvotimin 2014a/01R.dhe 2014a/02D në Prizren.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 nga Brikena Karadivaj nga Prizreni, me adresë rr. “Zenun Çoçaj” pn, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Komunës së Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se në vendvotimin me nr 2014a/01R dhe 2014a/02D nuk i rezulton numri i votave me personat që e kanë votuar. Më tej në apel thekson se e ka votuar familja e saj prej 7 anëtareve, por votat e tyre i mungojnë dhe kërkon qe të iu rinumërohen votat.

Apelit nuk i ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi se të njëjtës i mungojnë votat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Brikena Karavidaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimin 2014a/01R dhe 2014a/02D është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtrueses së apelit, se apelin e mbështet në pohimet e familjarëve të saj nuk është i argumentuar, për më tepër, Paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidatja ka pretenduar në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Brikena Karavidaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit nuk është e bazuar në asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3 LZP-së, barra e të provuarit bie mbi apeluesen, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje në vendvotimet 2014a/01R dhe 2014a/02D.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.859/2021 më datën 05.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momentin i marrjes së pranimimit të këtij vendimi.



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.859/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Gillogjani kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Komunës së Prizrenit Brikena Karavidaj, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.859/2021 i datës 03.11.2021, nga Brikena Karavidaj, kandidate për anëtare të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK,) me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërim i votave në vendvotimin 2014a/01R.dhe 2014a/02D në Prizren.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 nga Brikena Karadivaj nga Prizreni, me adresë rr. “Zenun Çoçaj” pn, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Komunës së Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se në vendvotimin me nr 2014a/01R dhe 2014a/02D nuk i rezulton numri i votave me personat që e kanë votuar. Më tej në apel thekson se e ka votuar familja e saj prej 7 anëtareve, por votat e tyre i mungojnë dhe kërkon qe të iu rinumërohen votat.

Apelit nuk i ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi se të njëjtës i mungojnë votat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Brikena Karavidaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimin 2014a/01R dhe 2014a/02D është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtrueses së apelit, se apelin e mbështet në pohimet e familjarëve të saj nuk është i argumentuar, për më tepër, Paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidatja ka pretenduar në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Brikena Karavidaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit nuk është e bazuar në asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3 LZP-së, barra e të provuarit bie mbi apeluesen, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje në vendvotimet 2014a/01R dhe 2014a/02D.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.859/2021 më datën 05.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.